



ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU
ENERGY REGULATORY OFFICE

LICENCË PËR OPERATORIN E SISTEMIT TË TRANSMISIONIT

DHËNË :

OPERATORIT TË SISTEMIT TË TRANSMISIONIT DHE TREGUT SH.A

Numri i Regjistrimit: ZRRE/Li_15/12



PËRMBAJTJA

KREU I: TERMAT E LICENCËS	3
KREU II: KUSHTET E LICENCËS	4
Neni 1: Përkufizimet.....	4
Neni 2: Llogaritë e Ndara për Aktivitetin e Operatorit të Transmisionit.....	5
Neni 3: Ndalimi i Subvencioneve dhe Ndër-Subvencioneve	5
Neni 4: Pajtueshmëria me Kodin e Rrjetit, Kodet e Matjes, Kodin e Shpërndarjes dhe Rregullat e Tregut	6
Neni 5: Funkionimi i Sistemit të Transmisionit	6
Neni 6: Tarifat dhe taksat për shfrytëzimin e sistemit të transmisionit.....	6
Neni 7: Plani Zhvillimor	7
Neni 8: Zotimi i zhvillimit të Infrastrukturës.....	7
Neni 9: Balancat e Energjisë Elektrike.....	7
Neni 10: Disponueshmëria dhe Mirëmbajtja e të Dhënave	7
Neni 11: Interkonektorët.....	8
Neni 12: Operimi i Sistemit.....	9
Neni 13: Blerja Ekonomike e Aseteve, Shërbimeve dhe Shërbimeve Ndihmëse	10
Neni 14: Regjistrimi dhe Tjetërsimi i Aseteve Relevante	10
Neni 15: Standardet e Sigurisë dhe Planifikimit të Sistemit të Transmisionit	11
Neni 16: Standardet e Sigurisë së Operimit	12
Neni 17: Standardet e Përgjithshme dhe Minimale gjatë Përbushjes së Aktiviteteve të Operimit të Transmisionit	12
Neni 18: Qasja në Tokë dhe /ose në Ndërtesa	13
Neni 19: Kufizimi në Përdorimin e Informatës së Caktuar	13
Neni 20: Dhënia e Informatave për Operatorët e tjerë të Sistemit dhe Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes.....	14
Neni 21: Pavarësia Ligjore dhe Menaxheriale	14
Neni 22: Rregullat e Tregut	14
Neni 23: Shëndeti dhe Siguria	15
Neni 24: Puna	15
Neni 25: Obligimi i Sigurimit.....	15
Neni 26: Ndryshimi në Kontrollin e të Licencuarit.....	15
Neni 27: Obligimet e Shërbimit Publik.....	15
Neni 28: Sigurimi i Informacioneve ndaj ZRRE-në	15
Neni 29: Vazhdimi, Modifikimi, Pezullimi, Transferimi dhe Ndërprerja e Licencës.....	16
Neni 30: Masat Administrative dhe Gjobat.....	16
Neni 31: Zgjidhja e Kontesteve	17



KREU I: TERMAT E LICENCËS

1. **Zyra e Rregullatorit për Energji** (tani e tutje “ZRRE”), në pajtim me autoritetin e dhënë me Ligjin për Rregullatorin e Energjisë (Ligji Nr. 03/L-185), Nenin 15 të Ligjit për Energjinë (Ligji Nr. 03/L-184), Ligjin për Energjinë Elektrike (Ligji Nr. 03/L-201), Rregullën për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë, dhe duke u bazuar në Vendimin e Qeverisë së Kosovës për caktimin Operatorit të Sistemit të Transmisionit dhe Tregut (KOSTT) si operator i vetëm i rrjetit të transmisionit të energjisë elektrike, **i modifikon KOSTT- OPERATORIT TË SISTEMIT TË TRANSMISIONIT DHE TREGUT SH.A.**(tani e tutje “ i Licencuari”) **Licencën për Operator të Sistemit të Transmisionit të Energjisë Elektrike.**
2. Territori që mbulohet nga kjo licencë është i tërë territori i Republikës së Kosovës.
3. I Licencuari nuk mund të marr licencë për prodhim, shpërndarje, furnizim të energjisë elektrike apo për prodhim të ngrohjes qendrore në pajtim me Nenin 31 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë.
4. I licencuari do të veproj në pajtueshmëri me Nenet e përcaktuara në këtë licencë, Ligjin për Energjinë Elektrike dhe legjislacionin tjetër në fuqi.
5. I licencuari do të veproj si vijon:
 - 5.1. kryej në mënyrë efikase obligimet e përcaktuara me këtë licencë;;
 - 5.2. të operojë në mënyrë efikase, ekonomike dhe të koordinuar me sistemin e transmisionit;
 - 5.3. bënë balancimin e sistemit dhe zbatimin e marrëveshjeve të aranzhuara duke nxitur efikasitetin e tij, në harmoni me Rregullat e Tregut.
6. Licenca vlen nga data **04 Tetor 2006** dhe do të vazhdojë të jetë e vlefshme për një periudhë tridhjetë (30) vjeçare, deri më **04 Tetor 2036** me mundësi vazhdimi, në pajtim me Rregullën për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë.
7. Në pajtim me Nenin 34 paragrafin 1 nënparagrafin 1.2 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë, kjo licencë modifikon licencën e operatorit të sistemit të transmisionit me numër licence ZRRE/Li_15/06 e lëshuar me datë 04 tetor 2006 nga Zyra e Rregullatorit për Energji, dhe hynë në fuqi me datë **18.07.2012.**

E Vulosur me vulën e rëndomtë të Zyrës së Rregullatorit për Energji me datë:_____.

Nënshkruar (në emër të Bordit të ZRRE-së):_____.



KREU II: KUSHTET E LICENCËS

Neni 1: Përkufizimet

1. Shprehjet e përdorura në këtë licencë do të kenë kuptim si në vijim:

"Anëtar" - marrëdhënie e drejtpërdrejt ose indirekte me të Licencuarin, çdo ndërmarrje Aksionare apo Vartës i të Licencuarit, apo ndonjë vartës i ndonjë ndërmarrje Aksionare të të Licencuarit, e themeluar sipas legjislacionit në fuqi.

"Programi i Pajtueshmërisë" – programi që kërkohet të përgatitet nga ana e të Licencuarit dhe i cili do të aprohet nga ZRRE-ja, sipas Nenit 11 të Ligjit për Energjinë Elektrike.

"Plani Zhvillimor" - çdo plan zhvillimor që do të përgatitet nga i Licencuari, sipas Nenit 7 të Ligjit për Energjinë.

"Vit financiar" - periudha prej 1 Janar deri më 31 Dhjetor të të njëjtit vit kalendarik.

"Kompani Aksionare" - çdo kompani e definuar si e tillë në përputhje me legjislacionin në fuqi në Kosovë.

"Legjislacion" – Ligji për Energjinë (Ligji Nr. 03/L - 184), Ligji për Rregullatorin e Energjisë (Ligji Nr. 03/L - 185), Ligji për Energjinë Elektrike (Ligji Nr. 03/L - 201) si dhe çdo legjislacion tjetër primar apo sekondar që rregullon sektorin e energjisë.

"Rregulla të Tregut" -rregulla të miratuara nga ZRRE që përcaktojnë funksionimin e tregut të energjisë elektrike dhe raportet në mes të Operatorit të Tregut, dhe pjesëmarrësve në treg, si dhe bashkëveprimet midis këtyre palëve dhe Operatorit të Sistemit të Transmisionit.

"Kode" - rregulla teknike të përpiluara nga Operatori i Sistemit të Transmisionit dhe Operatori i Sistemit të Shpërndarjes sipas Ligjit për Energji Elektrike dhe të aprovuara nga ZRRE-ja, në përputhje me Ligjin për Rregullatorin e Energjisë.

"Standardet e Sigurisë së Operimit" -dokument që do të përgatitet nga i Licencuari, në përputhje me Nenin 15 të kësaj licence.

"Vartës" - çdo kompani në pronësi apo e kontrolluar nga një kompani tjetër, e që definohet sipas legjislacionit në fuqi në Kosovë.

"Standardet e Sigurisë dhe Planifikimit të Sistemit të Transmisionit "- dokumenti që do të përgatitet nga i Licencuari në përputhje me Nenin 14 të kësaj licence.

2. Termet tjera të përdorura në këtë licencë do të kenë të njëjtin kuptimin si termet e përdorura në Legjislacionin në fuqi.



Neni 2: Llogaritë e Ndara për Aktivitetin e Operatorit të Transmisionit

1. I Licencuari do të përgatisë Pasqyrat Financiare vjetore për aktivitetet që përfshihen me këtë licencë, duke përjashtuar aktivitetet e Operatorit të Tregut, në përputhje me Udhëzimet Rregullative për Kontabilitetin, të nxjerrë nga ZRRE-ja, dhe do t'i dorëzojë ZRRE-së një kopje të Pasqyrave Financiare të audituara, brenda tre (3) muajve, pas përfundimit të vitit financiar.
2. I Licencuari do të dorëzojë në ZRRE Pasqyrat Financiare Vjetore të audituara nga auditor i pavarur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar brenda afateve të përcaktuara me ligjet në fuqi për raportimin financiar.
3. I licencuari në kontabilitetin e tij të brendshëm do të mbajë kontabilitetin për aktivitetin e Transmisionit në tërësi, si dhe për aktivitetet tjera. Kontabiliteti rregullativ do të jetë në përputhje me Udhëzimet Rregullative për Kontabilitet, i cili ndër të tjera mund të specifikojë:
 - 3.1. formën e deklaratave/regjistrave rregullative të kontabilitetit, duke përfshirë, por duke mos u kufizuar vetëm nga llogaritë e fitimeve dhe humbjeve, bilancet, fitimet e njohura dhe deklaratat e humbjeve, rrjedhjen e parave të gatshme dhe deklaratat për shumat e të ardhurave vjetore, kostove, asetëve, borxheve, rezervave ose furnizimeve, të cilat janë tarifuar nga ndonjë aktiviteti tjetër, ose janë përcaktuar nga alokimi ose shpërndarja midis aktiviteteve të konsoliduara të Operatorit të Sistemit të Transmisionit dhe ndonjë aktiviteti tjetër;
 - 3.2. natyrën dhe përmbajtjen e deklaratave/regjistrave rregullativ të kontabilitetit, duke përfshirë informacione mbi lloje të specifikuara të të ardhurave vjetore, shpenzimeve, asetëve ose borxheve, dhe informacione mbi të ardhurat vjetore, asetet, shpenzimet dhe borxhet nga aktivitetet e specifikuara; dhe
 - 3.3. parimet dhe politikat e kontabilitetit rregullativ (duke përfshirë bazat për alokimin e shpenzimeve).
4. Në lidhje me deklaratat e kontabilitetit rregullativ për sa i përket vitit financiar, i Licencuari nuk do të ndryshojë bazat e tarifimit, shpërndarjes ose alokimit që janë përdorur në vitin financiar paraprak, përveçse nëse ZRRE-ja nxjerr më parë udhëzimin relevant ose jep aprovimin me shkrim për ndryshimin e këtyre bazave.
5. I Licencuari do të veproj në pajtueshmëri me çdo udhëzim të nxjerrë nga ZRRE-ja dhe legjislacioni në fuqi.

Neni 3: Ndalimi i Subvencioneve dhe Ndër-Subvencioneve

I Licencuari do të parandalojë apo evitojë që aktiviteti i licencuar të japë apo të marrë ndonjë subvencion apo ndër-subvencion (direkt apo të tërthortë) prej ndonjë aktiviteti



tjetër të të Licencuarit dhe/ose ndonjë Vartësi (ortaku) apo anëtari, dhe/ose ndonjë personi tjetër.

Neni 4: Pajtueshmëria me Kodin e Rrjetit, Kodet e Matjes, Kodin e Shpërndarjes dhe Rregullat e Tregut

1. I Licencuari do të veproj në përputhje me dispozitat e Kodit të Rrjetit, Kodet e Matjes, Kodit të Shpërndarjes dhe Rregullave të Tregut.
2. Licencuari mund të kërkojë derogim (shtyrje) në zbatimin e atyre dispozitave dispozitave që nuk është e mundur të zbatohen sipas paragrafit 1 të këtij Neni, dhe ZRRE-ja pas shqyrtimit të kërkesës mund të lejojë apo refuzojë derogimin (shtyrjen) e afatit të zbatimit.

Neni 5 : Funkionimi i Sistemit të Transmisionit

1. I licencuari planifikon, operon, mirëmban dhe zhvillon sistemin e transmisionit në përputhje me Kodet teknike në fuqi.
2. I Licencuari është përgjegjës për funksionimin efikas, ekonomik dhe të koordinuar të sistemit të Transmisionit, duke përfshirë rrjedhat ndërkufitare të energjisë elektrike, në përputhje me legjislacionin në fuqi
3. I Licencuari është i obliguar të ofrojë kushtet për kyçje dhe përdorimin e sistemit të tij në përputhje me Rregullin për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji dhe rregullat e parimet që kanë të bëjnë me ngarkesat në transmision. Për çdo kontest që mund të paraqitet nga kyçja apo përdorimi i Sistemit të Transmisionit, do të zbatohet Rregullën për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë, të nxjerrë nga ZRRE-ja.
4. I Licencuari do të sigurojë qasje jo diskriminuese për shfrytëzuesit e sistemit apo kategoritë e shfrytëzuesve të sistemit, dhe t'u sigurojë informatat që ju nevojiten për qasje efikase në sistem, e në përputhje me Ligjin për Energjinë.

Neni 6: Tarifat dhe taksat për shfrytëzimin e sistemit të transmisionit

1. I Licencuari do t'u vendosë Palëve detyrime të aplikueshme për operimin e sistemit, shfrytëzimin e rrjetit të transmisionit dhe kyçje në rrjet (Detyrimet e Operatorit të Sistemit), ashtu siç përcaktohet në Rregullat e Tregut.
2. Tarifat dhe taksat për shfrytëzimin e sistemit të transmisionit do të përcaktohen në bazë të Metodologjisë për shfrytëzimin e sistemit të transmisionit dhe Metodologjisë së taksave të kyçjes në rrjetin e transmisionit.



3. Në përcaktimin e tarifave për shfrytëzimin e sistemit të transmisionit dhe taksave për kyçje, i Licencuari do të sigurojë sinjale të duhura për çmime jo diskriminuese ashtu që inkurajojnë qasjen e palëve të reja për kyçje në sistemin e transmisionit dhe qasjen në tregun e energjisë elektrike.
4. I Licencuari do të publikojë në faqen zyrtare elektronike të tij Rregulla për Çmimet dhe Tarifat e Energjisë Elektrike në Kosovë dhe Metodologjinë e Taksave për kyçje dhe shfrytëzim të Sistemit të Transmisionit, të aprovuar nga ZRRE-ja.

Neni 7: Plani Zhvillimor

1. Në përputhje me Nenin 7 të Ligjit për Energjinë dhe Nenit 12 të Ligjit për Energjinë Elektrike, dhe Nenit 14 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë, i Licencuari do të hartojë dhe publikojë planin Zhvillimor investiv afatmesëm (3-5 vjeçare) të dalë nga plani zhvillimor afatgjatë (10 vjeçar) i Sistemit të Transmisionit. Plani i tillë zhvillimor do të hartohet në përputhje me legjislacionin në fuqi duke konsultuar shfrytëzuesit aktual dhe potencial të sistemit. Para publikimit të Planit Zhvillimor, duhet të dorëzohet në ZRRE për aprovim.
2. I Licencuari do të rishikojë planin zhvillimor afatgjatë çdo vit, në mënyrë që informacioni i paraqitur në planin zhvillimor, të vazhdoj të jetë i saktë në të gjithë aspektet materiale. Propozimet eventuale për plotësimin apo ndryshimin e planit zhvillimor do të dorëzohen ZRRE-së për aprovim.

Neni 8: Zotimi i zhvillimit të Infrastrukturës

1. I Licencuari do të veproj në përputhje me zotimin e zhvillimit të infrastrukturës që rrjedh prej Programit të Zbatimit të Strategjisë së miratuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës, si dhe çdo zotim të infrastrukturës që rrjedhin nga Ligji për Energji. Kur zotimet për zhvillim të infrastrukturës i shkaktojnë të Licencuarit shpenzime plotësuese, ato shpenzime do të kthehen të licencuarit në përputhje me legjislacionin në fuqi.
2. I Licencuari do të raportojë çdo vit në ZRRE mbi aktivitetet që do të kryhen, në lidhje me zotimin e zhvillimit të infrastrukturës.

Neni 9: Balancat e Energjisë Elektrike

I Licencuari, pas konsultimit me ZRRE-në, do të paraqesë Ministrisë përkatëse Balancat e Energjisë elektrike, me parashikimet e nevojshme afatgjate dhe vjetore në pajtim me nenin 5 të Ligjit për Energji dhe Rregullat tjera në fuqi.

Neni 10: Disponueshmëria dhe Mirëmbajtja e të Dhënave

1. I Licencuari do të sigurojë që shfrytëzuesit aktual dhe ata potencial të Sistemit të Transmisionit do të kenë qasje jo-diskriminuese në informatat që atyre ju nevojiten për të



pasur qasje efikase në sistem, në pajtim me Ligjin për Energji Elektrike.

2. I licencuari do të marr të gjitha masat e nevojshme për të siguruar dhe zbatuar të gjitha detyrimet që dalin nga Legjislacioni në fuqi, licenca dhe marrëveshjet e lidhura.
3. I Licencuari është përgjegjës për mirëmbajtjen dhe publikimin e të dhënave për kapacitetet ndërkufitare, funksionimin e interkonektorëve, kongestionit, dispeçimin e kapaciteteve gjeneruese, shfrytëzimin e shërbimeve ndihmëse si dhe funksionimin e tregut balancues, si dhe të drejtat dhe obligimet lidhur me përdorimin e harduerit dhe softuerit të nevojshëm për kalkulimin e rrjedhave të fuqisë dhe informatat tjera.
4. ZRRE-ja mund të kërkojë nga i Licencuari që të mbledhë dhe mbajë informata, të dhëna dhe dokumente në përputhje me Nenin 28 të Rregullës për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë.

Neni 11: Interkonektorët

1. Në përputhje me Ligjin për Energjinë Elektrike dhe Rregullat e Tregut, i Licencuari bënë alokimin e kapaciteteve të linjave interkonektive me sistemet tjera në harmoni me procedurat e qarta dhe transparente për alokimin dhe shfrytëzimin e linjave interkonektive (ndërlidhëse), duke përfshirë menaxhimin e transitit të energjisë elektrike nëpër Sistemin e Transmisionit. Procedurat përkatëse dhe ndryshimet e tyre, do të dorëzohen në ZRRE për aprovim. Në momentin kur Rregullat Regjionale për alokimin e kapaciteteve transmetuese bëhen obligative, atëherë i Licencuari jo më vonë se tre (3) muaj para hyrjes në fuqi të Rregullave Regjionale, duhet të përgatisë procedurat relevante dhe t'i dorëzojë në ZRRE për aprovim.
2. Në bazë të Programit të Zbatimit të Strategjisë së Energjisë dhe sipas nevojave të regjionit i Licencuari do të vlerësoj dhe zhvillojë mundësitë për të ndërlidhur Sistemin e Transmisionit të Kosovës me sistemet tjera, do të përgatis çdo dy (2) vjet listën e kapaciteteve të reja të transmisionit dhe linjave interkonektive si dhe do të veprojnë në pajtim me çdo udhëzim të ZRRE-së dhe dispozitat relevante të Legjislacionit në fuqi.
3. I Licencuari, për çdo interkonektor dhe pas komisionimit të çdo linje interkonektive ndërlidhëse duhet të përgatisë një deklaratë për ZRRE-në, sa më shpejt që të jetë e mundur, dhe në çdo rast, jo më vonë se në datën e përcaktuar nga ZRRE-ja, ku tregohen:
 - 3.1. sasia totale e kapacitetit të çdo interkonektori dhe të gjithë interkonektorëve të parashikuar nga i Licencuari në baza vjetore, mujore dhe ditore, që do të jetë në dispozicion për transferimin në baza ditore të energjisë elektrike nga territori i veprimit të të Licencuarit tek Operatorët tjerë të Transmisionit jashtë territorit të tij dhe e kundërta;



- 3.2. margjina e kapacitetit rezervë të çdo interkonektori, që është propozuar nga i Licencuari dhe/ose nga ndonjë operator sistemi transmetues tjetër për sigurinë e sistemit; etj.
4. I Licencuari do të azhurojë në mënyrë të rregullt kapacitetet vjetore, mujore dhe ditore në dispozicion të paraqitura sipas paragrafit 3 të këtij neni, dhe në rast të modifikimit menjëherë do ta njoftoj ZRRE-në.
5. Deklarata, dhe deklaratat e modifikuara do të publikohen në faqen elektronike zyrtare të të Licencuarit.

Për qëllime të këtij Neni:

“Rregullat Regjionale” - rregulla obliguese për alokimin e kapaciteteve transmetuese të nxjerra sipas marrëveshjeve ndërkombëtare

Neni 12: Operimi i Sistemit

1. I Licencuari do të lëshoj urdhëresa direkte për dispeçimin e të gjitha njësive gjeneruese për ndryshimin e pikës së punës brenda kufijve dinamik, ndryshimit të ngarkesës dhe mjeteve tjera të nevojshme për balancimin e sistemit në përputhje me Kodin e Rrjetit dhe Rregullat e Tregut.
2. I Licencuari bën miratimin e programit një ditë para, sipas kërkesave dhe kritereve të mëposhtme:
 - 2.1. parashikimin e kërkesës totale të sistemit;
 - 2.2. kufizimet teknike të paraqitura kohë pas kohe në të gjithë sistemin ose në ndonjë pjesë të tij;
 - 2.3. karakteristikat e dinamikës operuese të njësive prodhuese dhe kapaciteteve transmetuese;
 - 2.4. parashikimet e eksporteve dhe importeve të energjisë elektrike në çdo linje interkonektive në përputhje me alokimin e kapaciteteve të transmisionit;
 - 2.5. humbjet teknike të parashikuara në transmisio;
 - 2.6. ndërprerjet e planifikuara sistemit të transmisionit për mirëmbajtje, riparim, zgjerim ose përforcim;
 - 2.7. Standardet e Sigurisë së Operimit , sipas Nenit 15 të kësaj Licence;
 - 2.8. mekanizmin balancues në përputhje me Rregullat e Tregut;
 - 2.9. energjinë elektrike të injektuar në sistemin e transmisionit nga njësitë e gjenerimit që nuk i nënshtrohen dispeçimit qëndror; dhe
 - 2.10. çështje të tjera që përcaktohen me legjislacionin në fuqi dhe Kodin e Rrjetit.
3. Gjatë nominimit dhe dispeçimit të energjisë së prodhuar, i Licencuari do t'i jap prioritet energjisë së prodhuar nga burimet e ripërtëritshme të energjisë dhe ko-gjenerimit siç kërkohet me Kodin e Rrjetit dhe në përputhje me Legjislacionin në fuqi.



4. I licencuari mirëmban sistemet matëse, grumbullon dhe distribuon matjet komerciale për qëllim të barazimit përfundimtar, në përputhje me Kodin e Matjes dhe Rregullat e Tregut.
5. I Licencuari do t'i raportoj ZRRE-së, në lidhje me funksionimin e sistemit, ose ndonjë aspekt tjetër të funksionimit, sipas kërkesave të ZRRE-së.

Në këtë Nen:

"Transferim interkonektiv" - rrjedhja e energjisë nëpër një linjë interkonektive ashtu siç parashihet me Kodin e Rrjetit.

Neni 13: Blerja Ekonomike e Aseteve, Shërbimeve dhe Shërbimeve Ndhmëse

1. I Licencuari do të kontraktojë dhe sigurojë asetet dhe shërbimet që janë të nevojshme për t'i mundësuar atij që të kryej detyrimin e tij sipas Kodit të Rrjetit. Kontraktimet e tilla do të bëhen në përputhje me Ligjin për prokurimin publik, dhe legjislacionin tjetër relevant në fuqi në Kosovë.
2. I licencuari do të jetë përgjegjës për aranzhimin e provizioneve të sasive dhe llojeve të shërbimeve ndhmëse, siç mund të jetë e nevojshme në mënyrë që të licencuarit t'i mundësohet kryerja e obligimeve të dhëna në Kodin e Rrjetit. Duke bërë këtë, i licencuari duhet të jetë në pajtim me Kodin e Rrjetit dhe Rregullat e Tregut dhe duhet të reflektojë parimet eficiencës, mos-diskriminimit dhe transparencës.
3. Gjatë kontraktimit për sigurimin e asetëve dhe shërbimeve në përputhje me paragrafin 1 dhe 2 të këtij Neni, i Licencuari, do të blejë ose do të sigurojë ato asetë, shërbime dhe shërbime ndhmëse nga burimet më ekonomike që ka në dispozicion.
4. Duke marr parasysh burimet më ekonomike që ka në dispozicion, i Licencuari duhet të ketë parasysh sasinë, natyrën, shumëllojshmërinë, numrin dhe sigurinë e asetëve, shërbimeve dhe Shërbimeve Ndhmëse që janë në dispozicion për blerje ose për përvetësim tjetër, dhe sipas nevojave të tij t'i mundësoj që ai t'i kryej obligimet sipas Legjislacionit në fuqi, Kodit të Rrjetit dhe kësaj licence.

Neni 14: Regjistrimi dhe Tjetërsimi i Aseteve Relevante

1. I Licencuari do të përgatisë dhe do të mbajë një regjistër të të gjithë asetëve relevante dhe do t'i dorëzojë ZRRE-së me çdo ndryshim në regjistër jo më vonë se 31 Janar të çdo viti.
2. I Licencuari nuk do të shes apo heq dorë nga kontrolli funksional mbi ndonjë aset relevant, nëse kjo do të ndikonte në aftësinë e tij për të kryer detyrimet e tij. Në rast kur i Licencuari dëshiron të tjetërsoi asetet, apo pasuritë tjera që përdoren në ushtrimin e aktivitetit të licencuar, ku vlera e tyre tejkalon shumë njëqind mijë euro (100,000.00 €), i



Licencuari do të obligohet që ta njoftoj ZRRE-në me shkrim. I Licencuari mund ta bëj tjetërsimin e ndonjë asemi të tillë vetëm pas miratimit me shkrim nga ZRRE-ja.

1. Në këtë Nen:

"Tjetërsim"- çdo shitje, transferim, dhurim, dhënie me qira, hua, hipotekë, ngarkimin, kufizim mbi shfrytëzimin (qoftë ky fizik ose ligjor) ose ndonjë ngarkesë tjetër, si dhe lejimin e ndonjë ngarkese ndaj një aktiviteti tjetër të të Licencuarit dhe/ose pale të tretë.

"Aset relevant" nënkupton:

- a) Çdo pajisje e e Sistemit të Transmisionit që shfrytëzohet nga i Licencuari për të kryer funksionet e veta siç përcaktohet në paragrafin 2 të këtij Neni;
- b) Çdo interes ligjor ose përfitues mbi tokën dhe/ose ndërtesat në të cilat janë vendosur të sipërpërmendurit, dhe/ose që shfrytëzohet nga i Licencuari për të kryer funksionet që përcaktohen në këtë licencë; dhe
- c) Çdo e drejtë pronësore përkatëse intelektuale.

Neni 15: Standardet e Sigurisë dhe Planifikimit të Sistemit të Transmisionit

1. I Licencuari, është përgjegjës për mirëmbajtjen dhe kur është e domosdoshme rifreskimin e dokumentit Standardet e Sigurisë dhe Planifikimit të Sistemit të Transmisionit. Çdo ndryshim i dokumentit duhet të dërgohet në ZRRE për aprovim.
2. I Licencuari do t'i zbatojë Standardet e Sigurisë dhe Planifikimit të Sistemit të Transmisionit dhe do të jetë përgjegjës për funksionimin, sigurimin e mirëmbajtjes së Sistemit të Transmisionit, dhe nëse është e nevojshme, edhe zhvillimin e tij në përputhje me Standardet e Sigurisë dhe Planifikimit të Sistemit të Transmisionit si dhe me standarde të tjera të planifikimit dhe operimit të cilat i Licencuari mund t'i zbatojë, pas aprovimit nga ZRRE-ja.
3. I Licencuari do të shqyrtojë kohë pas kohe zbatimin e Standardeve të Sigurisë dhe Planifikimit të Sistemit të Transmisionit, dhe do të dorëzojë në ZRRE:
 - 3.1. një raport të rezultateve të këtij shqyrtimi; dhe
 - 3.2. propozimin për amendamentim eventual të Standardeve të Sigurisë dhe Planifikimit të Sistemit të Transmisionit.
4. ZRRE-ja mund të nxjerrë udhëzime që i kërkon të Licencuarit të rishikojë Standardet e Sigurisë dhe Planifikimit të Sistemit të Transmisionit, në atë mënyrë që është specifikuar në udhëzime.
5. I Licencuari do të publikojë në faqen elektronike zyrtare të tij, Standardet e Sigurisë dhe Planifikimit të Sistemit të Transmisionit.
6. I Licencuari mund të kërkojë derogim (shtyrje) në zbatimin e disa pjesëve të Standardeve të Sigurisë dhe Planifikimit të Sistemit të Transmisionit. ZRRE-ja pas



shqyrtimit të kërkesës nga i licencuari mund të lejojë apo refuzojë derogimin (shtyrjen) e afatit të zbatimit.

Neni 16: Standardet e Sigurisë së Operimit

1. I Licencuari do të implementojë Standardet e Sigurisë së Operimit, të aprovuara nga ZRRE.
2. I Licencuari do të zbatoj Standardet e Sigurisë së Operimit dhe do të jetë përgjegjës për funksionimin e Sistemit të Transmisionit në përputhje me këto Standarde.
3. I Licencuari do të rishqyrtojë herë pas here zbatimin e Standardeve të Sigurisë së Operimit dhe nëse ka ndryshime, do të dorëzojë në ZRRE:
 - 3.1. një raport të rezultateve të rishqyrtimit të tillë; dhe
 - 3.2. ndryshimet që propozohen të bëhen Standardeve të Sigurisë së Operimit.
4. ZRRE-ja mund të nxjerrë udhëzime me të cilat kërkon nga i Licencuari që të rishikoj Standardet e Sigurisë së Operimit në atë mënyrë që do të specifikohet në ato udhëzime, dhe i Licencuari do të veproj në pajtueshmëri me ato udhëzime.
5. I Licencuari do të publikoj në faqen elektronike zyrtare të tij Standardet e Sigurisë së Operimit.

Neni 17: Standardet e Përgjithshme dhe Minimale gjatë Përbushjes së Aktiviteteve të Operimit të Transmisionit

1. I Licencuari do të veproj në pajtueshmëri me të gjitha standardet e cilësisë së furnizimit dhe shërbimit me energji elektrike të aprovuar nga ZRRE-ja.
2. Kur ZRRE kërkon, apo kur i Licencuari e konsideron si të arsyeshme, i Licencuari do të shqyrtojë standardet ekzistuese të përgjithshme dhe minimale të përbushjes dhe brenda afatit të përcaktuar nga ZRRE.
3. I Licencuari do të zbatoj standardet e aprovuara dhe do t'i propozojë ZRRE-së për aprovim procedurën e monitorimit të përbushjes së standardeve të cilësisë dhe furnizimit me energji elektrike. I Licencuari do të veproj në pajtueshmëri me procedurat e aprovuara.
4. I Licencuari do t'i sigurojë ZRRE-së jo më vonë se 31 Mars të çdo viti raport mbi ushtrimin e veprimtarisë lidhur me standardet që duhet përbushur. Ky raport do të përfshijë informata dhe analiza lidhur me përbushjen e standardeve sipas këtij Neni.



5. I Licencuari deri me 31 Mars të çdo viti kalendarik do të publikojë statistikën ashtu si ZRRE-ja i kërkon, lidhur me përmbushjen ose mos përmbushjen e standardeve të përcaktuara sipas këtij Neni.

Neni 18: Qasje në Tokë dhe /ose në Ndërtesa

1. I Licencuari do të zbatojë Kodin e Punës i cili përcakton parimet dhe procedurat që do të ndjekë në lidhje me ndonjë person që vepron në emër të të Licencuarit dhe që kërkon qasje në tokë dhe/ose ndërtesë e që lidhet me ushtrimin e aktivitetit të licencuar.
 - 2.1. posedon aftësitë e nevojshme për të kryer detyrat e kërkuara;
 - 2.2. mund të identifikohet nga publiku, dhe
 - 2.3. janë persona të autorizuar për të vizituar dhe hyrë në tokat apo ndërtesat.
3. I Licencuari do të rishqyrtojë kohë pas kohe Kodin e Punës dhe çdo ndryshim i këtij Kodi do t'i nënshtrohet aprovimit të ZRRE-së.

Neni 19: Kufizimi në Përdorimin e Informatës së Caktuar

1. I Licencuari aty ku është e domosdoshme për kryerjen e aktivitetit të Licencuar, do të zbulojë çdo informacion, përveç atyre informatave konfidenciale, që i mban dhe/ose i ka siguruar gjatë kryerjes së funksioneve të veta si Operator i Sistemit të Transmisionit. Pavarësisht nga kjo, i Licencuari do ti ofroj çdo informatë ZRRE-së që ajo mund t'i kërkojë në kryerjen e obligimeve që i janë dhënë me Legjislacionin në fuqi dhe Nenin 27 të kësaj licence apo Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes, dhe operatorët tjerë të sistemit, kur informatat e tilla janë të domosdoshme që Operatori i Sistemit të Transmisionit të përmbushë obligimet e përcaktuara me legjislacionin në fuqi dhe me këtë Licencë.
2. I Licencuari do të sigurojë që për çdo dokument që përmban informacione konfidenciale (të fshehta), duhet ta bëjë identifikimin e qartë të informacionit si konfidencial (ta shënjojë si informatë konfidenciale).
3. I Licencuari do të marrë masat e parapara për të parandaluar zbulimin e informacioneve konfidenciale nga çdo person dhe këto informata nuk mund të përdoren apo zbulohen për ndonjë qëllim tjetër nga ajo që është dhënë sipas dispozitave përkatëse të ligjeve në fuqi.
4. Në këtë Nen "Informata Konfidenciale" do ta ketë kuptimin e njëjtë të përcaktuar me Ligjin për Rregullatorin e Energjisë.



Neni 20: Dhënia e Informatave për Operatorët e tjerë të Sistemit dhe Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes

1. Në mënyrë që të sigurojë funksionim efikas, zhvillim të koordinuar dhe ndërfunksionimin të sistemeve të ndërlidhura, i Licencuari do t'i dërgojë çdo informatë të domosdoshme Operatorit të Tregut, Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes dhe Operatorëve të Sistemeve fqinje që janë të ndërlidhur, në atë mënyrë dhe në atë kohë që me arsye mund të jetë kërkuar nga Operatori i Tregut, Operatori i Sistemit të Shpërndarjes dhe Operatorët e Sistemeve fqinje.
2. Në rast të paraqitjes së ndonjë kontesti në mes të Licencuarit dhe ndonjë pale tjetër, i Licencuari do të procedojë në përputhje me Rregullën për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë, të nxjerrë nga ZRRE.

Neni 21: Pavarësia Ligjore dhe Menaxheriale

1. Për të siguruar pavarësinë e të Licencuarit:
 - 1.1 Personat përgjegjës për menaxhimin e të Licencuarit nuk do të marrin pjesë në strukturën e ndonjë ndërmarrje të licencuar për prodhim, shpërndarje apo furnizim me energji elektrike në Kosovë, dhe
 - 1.2 I Licencuari do të ndërmerr të gjitha masat e domosdoshme për të siguruar se interesat profesionale të personave përgjegjës për menaxhimin e të Licencuarit, janë marr në konsideratë për të siguruar se ata janë të aftë për të vepruar në mënyrë të pavarur.
2. I Licencuari do të zbatojë Kodin e Sjelljes të Operatorit të Sistemit të Transmisionit, ku përcaktohen masat e domosdoshme që sigurojnë përjashtimin e sjelljeve diskriminuese. Gjithashtu ky kod do të përmbajë obligimet specifike të drejtorëve dhe të punësuarve tjerë lidhur me çështjet që kanë të bëjnë me konfidencialitetin, konfliktin e interesit etj.
3. I Licencuari do të publikojë në faqen e tij elektronike zyrtare Kodin e Sjelljes.

Neni 22: Rregullat e Tregut

1. I Licencuari do të veprojë në pajtim me Rregullat e Tregut në fuqi.
2. I Licencuari mund të kërkojë derogim (shtyrje) në zbatimin e disa dispozitave të Rregullave të Tregut, dhe ZRRE-ja pas shqyrtimit të kërkesës mund të lejojë apo refuzojë derogimin (shtyrjen) e afatit të zbatimit.



Neni 23: Shëndeti dhe Siguria

1. I Licencuari do të ndërmarrë të gjithë hapat e nevojshëm për të mbrojtur personat nga lëndimet dhe dëmtimet që mund tu shkaktohen atyre nga ana e të Licencuarit gjatë kryerjes së aktivitetit të Operatorit të Sistemit të Transmisionit, në përputhje me Legjislacionin në fuqi.
2. I Licencuari në përputhje me legjislacionin në fuqi, do të kryej kontroll (auditim) teknik të sigurisë të Sistemit të Transmisionit në baza vjetore, dhe rezultatet e një kontrolli të tillë, do t'i dërgojë në ZRRE, sa herë që kjo kërkohet nga ZRRE-ja

Neni 24: Puna

I Licencuari lidhur me marrëdhënien në punë dhe sigurinë në punë do të veprojë në pajtim me legjislacionin në fuqi në Kosovë.

Neni 25: Obligimi i Sigurimit

1. Licencuari do të bëjë sigurimin e aseteve në pajtim me legjislacionin në fuqi në Kosovë.
2. I licencuari do të lidhë kontrata për sigurimin e aseteve të sistemit të transmisionit dhe për pajisjet që përdoren për transmisionin e energjisë elektrike. Kontrata e tillë do t'i dërgohet ZRRE-së për rishikim në baza vjetore.

Neni 26: Ndryshimi në Kontrollin e të Licencuarit

1. Licencuari do të njoftojë ZRRE-në për ndonjë ndryshim që pritet në kontroll së paku gjashtëdhjetë (60) ditë paraprakisht. Ndryshimi në kontroll nuk do të jetë efektiv deri sa ZRRE-ja nuk e aprovon atë.
2. I Licencuari do të njoftojë ZRRE-në për ndonjë ndryshim të Strukturës Organizative të të Licencuarit. Njoftimi i tillë do t'i bëhet ZRRE-së jo më vonë se tre (3) ditë nga data e çdo ndryshimi të tillë.

Neni 27: Obligimet e Shërbimit Publik

I Licencuari do të kryej çdo obligim të shërbimeve publike që mund t'i vendoset nga ZRRE-ja, sipas Nenit 47 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë.

Neni 28: Sigurimi i Informacioneve ndaj ZRRE-në

1. I Licencuari do të dorëzojë në ZRRE informacione dhe raporte në mënyrën dhe në afatet që ZRRE-ja mund t'i konsiderojë të nevojshme.
2. I Licencuari do të dërgojë në ZRRE raporte tremujore dhe vjetore mbi veprimtarinë e



Operatorit të Sistemit të Transmisionit si dhe pajtueshmërinë me kushtet e Licencës sipas Doracakut të Raportimit për Sektorin e Energjisë, të miratuar nga ZRRE-ja

1. Nëse i Licencuari, në përputhje me Rregullën për Informatat Konfidenciale, kërkon që një informacion i caktuar të konsiderohet si konfidencial atëherë është obligim i tij që të shënjojë atë informacion si konfidencial dhe të arsyetojë kërkesën e tij te ZRRE-ja. ZRRE do të shqyrtojë kërkesën e tillë në pajtim me Rregullën për Informatat Konfidenciale.
2. ZRRE ka të drejtë të kërkojë nga i licencuari çdo informatë konfidenciale, të nevojshme për përmbushjen e funksioneve dhe detyrave të saj, në pajtim me Nenin 12 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë.
3. I Licencuari duhet t'i dërgojë ZRRE-së detajet për çdo ndryshim në informata që janë dërguar gjatë aplikimit për këtë licencë.

Në këtë Nen:

"Informacion" - materiali në çdo formë dhe pa asnjë kufizim do të përfshijë çdo kontratë, libër, dokument, regjistër, kontabilitet, llogaritje (statusore ose tjetër), vlerësim, kthim ose raport të çdo përshkrimi dhe çdo shpjegim (gojor ose me shkrim) në lidhje me këto informacione që mund të jenë kërkuar nga ZRRE-ja.

Neni 29: Vazhdimi, Modifikimi, Pezullimi, Transferimi dhe Ndërprerja e Licencës

1. ZRRE-ja mund të vazhdojë, modifikojë, pezullojë, dhe ndërpresë këtë licencë në përputhje me Ligjin për Rregullatorin e Energjisë dhe Rregullën për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë.
2. ZRRE-ja mund të transferojë këtë licencë në përputhje me Ligjin për Rregullatorin e Energjisë dhe Rregullën për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë, por duke siguruar që obligimet e licencës mund të kryhen nga i Licencuar tjetër, nëse konsumatorët nuk do të dëmtohen për shkak të transferimit të tillë.

Neni 30: Masat Administrative dhe Gjobat

1. Në rast shkeljeje të dispozitave të legjislacionit në fuqi, përfshirë Rregullat e nxjerra nga ZRRE, Nenet e kësaj Licence apo instruksionet dhënë të Licencuarit nga ana e ZRRE-së, ZRRE-ja ka kompetenca t'i vendos të licencuarit masa administrative dhe gjoba, në përputhje me Nenin 52 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë dhe Rregullën për Masat Administrative dhe Gjobat.
2. Masat administrative dhe gjobat mund t'i vendosen ndërmarrjes si subjekt juridik si dhe personave përgjegjës të ndërmarrjes.



3. Shuma e gjobës do të vlerësohet në pajtim me Ligjin për Rregullatorin e Energjisë dhe Rregullën për Masat Administrative dhe Gjobat.

Neni 31: Zgjidhja e Kontesteve

1. Çdo kontest që paraqitet apo është i lidhur me aktivitetet e licencuara do të zgjidhet në përputhje me Rregullën për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë, të nxjerrë nga ZRRE-ja
2. Vendimet e ZRRE-së lidhur me vazhdimin, modifikimin, pezullimin, ndërprerjen dhe transferin e licencës si dhe vendimet lidhur me gjobat si rezultat i shkeljeve të kushteve të licencës apo shkeljes së ligjeve të aplikueshme, mund të kontestohen nga i Licencuari në gjykatën kompetente sipas ligjeve në fuqi.